

20190070107

**LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË DETYRIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E BLERJES SË AUTOBUSËVE TË
RINJ PËR QYTETIN E SHKUPIT, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE NDËRMARRJES SË
TRANSPORTIT PUBLIK SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e blerjes së autobusëve të rinj për Qytetin e Shkupit, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes së Transportit Publik Shkup në shumë prej 10.000.000 euro, nëse Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup nuk i plotëson dhe servison detyrimet e Marrëveshjes për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas përcaktohen me Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Ndërmarrjes së Transportit Publik Shkup.

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Afati i pagimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është dhjetë vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tri vitesh.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmujor të rritur për margjinë prej 1%.

Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1% të shumës së huas.

Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion në lartësi prej 0,5% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që rrjedhin nga Marrëveshja për hua, Marrëveshja për garanci dhe Marrëveshja për garanci komunale, Ministria e Financave, Qyteti i Shkupit dhe Ndërmarrja e Transportit Publik Shkup do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".